



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/116

Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Shërbime.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/116

Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/116

Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës së Pensioneve të Veteranëve dhe Kategorive Tjera të Luftës.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/116

Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E GRUPEVE PUNUESE SEKTORIALE DHE GRUPEVE PUNUESE NËN-SEKTORIALE PËR KOORDINIMIN E DONATORËVE TË JASHTËM

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij vendimi është themelimi i Grupeve Punuese Sektoriale (GPS) dhe Grupeve Punuese Nën-Sektoriale (GPNS) në kuadër të GPS, për koordinimin e donatorëve të jashtëm në Republikën e Kosovës, si dhe përcaktimi i institucioneve pjesëmarrëse dhe udhëheqëse, për të zbatuar Rregulloren Nr. 09/2015 për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Emërtimi, përbërja e përhershme, kryesimi dhe bashkëkryesimi i Grupeve Punuese Sektoriale dhe Grupeve Punuese Nën-Sektoriale.

Themelohen grupet punuese sektoriale si në vijim:

- 2.1. Qeverisja;
- 2.2. Sundimi i ligjit;
- 2.3. Bujqësia dhe zhvillimi rural;
- 2.4. Infrastruktura;
- 2.5. Ekonomia, tregtia dhe industria;
- 2.6. Kapitali njerëzor.

Në përputhje me Rregulloren Nr. 09/2015 për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian janë anëtarë të përhershëm të të gjitha grupeve punuese sektoriale.

Të gjitha grupet punuese sektoriale kryesohen nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit që përcaktohet me këtë vendim si udhëheqës i sektorit dhe bashkëkryesohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Integritimit Evropian.

Të gjitha grupet punuese nën-sektoriale kryesohen nga përfaqësuesit e Departamenteve për Integrim Evropian dhe Koordinimin e Politikave në kuadër të ministrive apo zyrtarëve përkatës në rastet e institucioneve të pavarura që me këtë vendim përcaktohen si udhëheqëse të nën-sektorit.

Neni 3 GPS Qeverisja

GPS Qeverisja kryesohet nga Zyra e Kryeministrit dhe përfshinë: Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Ministria e Administratës Publike (duke përfshirë Institutin e Kosovës për Administratë Publike), Ministria e Financave (duke përfshirë Doganat e Kosovës dhe Administratën Tatimore të Kosovës), Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Në kuadër të GPS Qeverisja, do të funksionojnë këto grupe punuese nën-sektoriale:

- 3.1. Reforma e administratës publike – kryesuar nga Ministria e Administratës Publike;
- 3.2. Menaxhimi i financave publike – kryesuar nga Ministria e Financave.

Neni 4 GPS Sundimi i Ligjit

GPS Sundimi i ligjit kryesohet nga Ministria e Drejtësisë dhe përfshin: Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Institutin Gjyqësor të Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme (duke përfshirë Inspektoratin Policor të Kosovës, Policia e Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave dhe Agjencia Kosovare e Forenzikës), Ministria për Komunitete dhe Kthim, Komisioni i Pavarur i Medieve, Agjencia kundër Korrupsionit, Avokati i Popullit, Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra për Qeverisje të Mirë dhe Zyra për Çështje të Komuniteteve në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Në kuadër të GPS Sundimi i ligjit, do të funksionojnë këto grupe punuese nën-sektoriale:

- 4.1. Drejtësia – kryesuar nga Ministria e Drejtësisë;
- 4.2. Punët e brendshme – kryesuar nga Ministria e Punëve të Brendshme;
- 4.3. Të drejtat e njeriut dhe komuniteteve – kryesuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë (Zyra e Kryeministrit)

Neni 5 GPS Bujqësia dhe Zhvillimi Rural

GPS Bujqësia dhe zhvillimi rural kryesohet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe përfshin Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Në kuadër të GPS Bujqësia dhe zhvillimi rural, do të funksionojnë këto grupe punuese nën-sektoriale:

- 5.1. Bujqësia dhe zhvillimi rural – kryesuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 5.2. Pylltaria dhe peshkataria-kryesuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- 5.3. Siguria e ushqimit – kryesuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Neni 6 GPS Infrastruktura

GPS Infrastruktura kryesohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe përfshinë: Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, KEK, Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Infrastrukturës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Autoriteti i Aviacionit Civil, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës Sh.A "INFRAKOS", Trainkos Sh.A, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përfshirë në kuadër të saj Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës, Institutin për Planifikim Hapësinor dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Në kuadër të GPS Infrastruktura, do të funksionojnë këto grupe punuese nën-sektoriale:

- 6.1. Energjia – kryesuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- 6.2. Teknologjia e informimit dhe komunikimit – kryesuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe bashkëkryesuar nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (MAP);
- 6.3. Transporti hekurudhor – kryesuar nga Ministria e Infrastrukturës;
- 6.4. Transporti rrugor – kryesuar nga Ministria e Infrastrukturës;
- 6.5. Aviacion civil – kryesuar nga Ministria e Infrastrukturës;
- 6.6. Mjedi dhe ndryshimet klimatike – kryesuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- 6.7. Planifikimi hapësinor, banimi dhe ndërtimi – kryesuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 7 GPS Ekonomia, tregtia dhe industria

GPS Ekonomia, tregtia dhe industria kryesohet nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe përfshinë: Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, Ndhimën Shtetërore, si dhe Administratën Tatimore dhe Doganat në kuadër të Ministrisë së Financave.

Në kuadër të GPS Ekonomia, tregtia dhe industria, do të funksionojnë këto grupe punuese nën-sektoriale:

- 7.1. Tregu i brendshëm, doganat dhe konkurrenca – kryesuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- 7.2. Politikat industriale – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- 7.3. Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, promovimi i investimeve, eksportit dhe turizmit – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Neni 8
GPS Kapitali Njerëzor

GPS Kapitali njerëzor kryesohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet e saj vartëse, dhe përfshinë: Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë duke përfshirë Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve, Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, Ministrinë e Shëndetësisë duke përfshirë Agjencinë për Financimin e Shëndetësisë, Agjencinë për Produkte dhe Pajisje Mjekësore, Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, Inspektoratin Shëndetësor dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në kuadër të GPS Kapitali njerëzor, do të funksionojnë këto grupe punuese nën-sektoriale:

- 8.1. Arsimi, aftësitë profesionale dhe trajnimet - kryesuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- 8.2. Arsimi i lartë dhe hulumtimet - kryesuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- 8.3. Arsimi para-universitar - kryesuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- 8.4. Punësimi dhe tregjet e punës - kryesuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 8.5. Përfshirja sociale, ulja e varfërisë dhe mundësitë e barabarta - kryesuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- 8.6. Kultura dhe trashëgimia kulturore - kryesuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 8.7. Sporti - kryesuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 8.8. Rinia - kryesuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- 8.9. Shëndeti publik - kryesuar nga Ministria e Shëndetësisë.


Neni 9

Funksionimi dhe përgjegjësitë e Grupeve Punuese Sektoriale dhe Grupeve Punuese Nën-sektoriale.

Funksionimi dhe përgjegjësitë e Grupeve Punuese Sektoriale Grupeve Punuese Nën-sektoriale janë të rregulluara sipas Rregullores Nr. 09/2015 për Koordinimin e Asistencës së Donatorëve të Jashtëm në Republikën e Kosovës dhe akteve normative të lëshuara në funksion të zbatimit të saj nga Ministria e Integritimit Evropian.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/116


Datë: 16 .11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e "Marrëveshjes për punën fitimprurëse të anëtarëve të familjeve të anëtarëve të një misioni diplomatik apo posti konsullor të karrierës" ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Kanadasë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/116


Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e "Marrëveshjes për vlefshmërinë e pasaportave të Kosovës për dhënie e vizave jo-emigruese të Shteteve të Bashkuara" ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
2. Përgjatë negociimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/116

Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e "Marrëveshjes për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë për Tatimet në të Ardhurat dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal dhe Shmangia" ndërmjet Republikës së Austrisë dhe Republikës së Kosovës.
2. Përgjatë negociimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave që të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/116

Datë: 16.11.2016


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i ndërtesave të përhershme të menaxhimit të integruar te kufirit IBM: Pikat Kufitare Bërnjak dhe Merdare, Zona Kadastrale Banjë, Komuna e Zubin Potokut dhe Merdare, Komuna e Podujevës, sipas tabelave 1 dhe 2 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Revokohet pjesërisht Vendimi Përfundimtar nr. 08/49 datë 16.09.2015, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Kosovës nr. 31/30 Shtator 2015, për Zonën kadastrale Banjë, Komuna Zubin Potok, parcelat: Nr. 1563-0, 1564-0 dhe 1565-0 dhe Zona Kadastrale Merdare, Komuna Podujevë, parcelat: Nr. 51-1, 51-2, 51-3, 53-2, 50-0, 15-1, 15-2, 13-0, 49-0, 48-0.
3. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokollit 2443/16 datë 26.05.2016.
4. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
5. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
6. Kundër këtij vendimi, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë në gjykatën kompetente, vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

7. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente, parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
8. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
9. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrimin në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyrat kadastrale janë të obliguara të kryejnë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
10. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/116

Datë: 16.11.2016


Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 10 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës me nr. prot. 2688/2 datë 02.11.2016, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Sektorët: C1, C2, C2a dhe C2b, Zonat Kadastrale: Preoc, Suhudoll, Dobratin, Komuna Graçanicë, Lipjan, Babush i Muhaxherëve, Konjuh, Smallushë, Marec, Gadime e Ulët, Banullë, Komuna Lipjan, Papaz, Sazli, Babush i Sërbëve, Mirash, Cërnillë, Rahovicë, Softaj, Bibaj, Fshati i Vjetër, Pojatë, Sojevë, Komogllavë, Talinoc i Muhaxherëve, Gërllicë, Rakaj, Komuna Ferizaj dhe Zonat Kadastrale Koxhaj dhe Kaçanik i Vjetër, Komuna Kaçanik, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi, apo cilëndo pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Financave.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/116


Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ Nr. 31/15 Qershor 2008), dhe të nenit 6 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (GZ Nr. 13/30 Maj 2012), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Ndërmarrja Publike Lokale NPL "TREGU" Sh.A Gjilan.
2. Ndërmarrja Publike Lokale "TREGU" Sh.A, themelohet me 100% Aksione nga Kuvendi Komunal i Gjilanit.
3. Autorizohet Komuna e Gjilanit që të veprojë në emër të aksionarit të vetëm në NPL "TREGU" Sh.A dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e ligjshme, duke përfshirë regjistrimin sipas Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare (GZ Nr. 39/01 tetor 2008).
4. Komuna e Gjilanit të drejtat e saj të aksionarit do t'i ushtrojë nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, në emër të Komunës përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Obligohet Komuna e Gjilanit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/116


Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Shërbimet Postare.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/116


Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 20,000.00 (njëzet mijë euro), për përkrahje të projektit të Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës (KKAfZhK) për rehabilitim të familjarëve të personave të zhdukur.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti për shpenzimet e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere dhe barten në llogarinë bankare me nr. 1503001002032142- Raiffeisen Bank, të Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës (KKAfZhK).
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/116

Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Informata e prezantuar nga Ministri i Financave, lidhur me Raportin për performancën e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar - tetor 2016.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/116

Datë: 16.11.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke iu referuar kërkesës me nr. prot. 3462 datë 14.11.2016, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 30,000.00 (tridhjetë mijë euro) për renovimin e objektit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës OVL-UÇK-së.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi transferohen prej Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nga nën programi Pensionet për Invalidët e Luftës me kod 003, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirrollogarinë e OVL-UÇK-së nr. 1701001010734491 - NLB.
3. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës OVL-UÇK-së për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë